



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 651-7687 2023

Klinë, datë 03/03 2023

*Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në Gazetën Zyrtare, më dt.04.06.2008 nr.28, në nenin 91 paragrafi 1 i Statutit të Komunës së Klinës, të dt.07.04.2010, në nenin 2 pika 2.3 dhe nenin 4 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-49, duke marrë parasysh dispozitat e nenit 5 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve, nr.06-4043/2015, si dhe kërkesën, nr.01-644-6723/2023 të dt.03.03/2003 të parashtruar nga Zyrtarja për Barazi Gjinore, Kryetari i Komunës së Klinës, **mori këtë;***

V E N D I M

1. **APROVOHËT**, në shumën prej **500.00 €** (pesëqind euro) kërkesa, nr.01-644-6732/2023 e datës 03.03/2023 e parashtruar nga Zyra për Barazi Gjinore- Klinë, që ka të bëjë me ndarjen e mjeteve financiare me qëllim të realizimit të vizitës së grave për nder të 8 marsit në Republikën e Malit të Zi. Mjetet në vlerë prej **500.00 €** paguhen nga subvencionet e zyrës së kryetarit të komunës.
2. Mjetet si nga pika 1 e këtij vendimi i dedikohen realizimit të vizitës të përmendur si në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat mjete derdhen në xhirrollogari të Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale- Klinë.
3. Për ekzekutimin e këtij vendimi kujdeset Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit.
4. Obligohet zyra për barazi gjinore që në bashkëpunim me Shoqatën Sindikale të Punëtorëve të Administratës së Komunës së Klinës, që lidhur me mjetet e ndara Komunës së Klinës t'ia paraqes raportin kthyes të shpenzimeve.
5. Ky vendim është i plotëfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Drejtoria e Financave;
- Zyra për barazi gjinore;
- Përfaqësuesi i Sindikatës, si dhe;
- Arkivi.



Kryetari,
Zenun Elezaj